


Korrupsioni nën Këndvështim

Aktiviteti 1
Fleta e Mësuesit

Vlerat	Transparenca, Ndershmëria, Drejtësia, Sakrifika
Qëllimet	Pedagogjike: Reflektimi mbi rëndësinë e transparencës dhe ndershmërisë në marrëdhëniet ndërpersonale; Nxitja e analizave, reflektimit dhe debatit. Praktike: Konsiderimi i fenomenit të korrupsionit Njohja e formës se si e konceptojnë të tjerët korrupsionin; Krijimi e një pllake informative.
Pjesëmarrësit	Të gjithë nxënësit e klasës Minimumi: 3 pjesëmarrës Maksimumi: 30 pjesëmarrës
Kohëzgjatja	120 minuta
Materialet	Fleta e aktivitetit për çdo nxënës Letër ose tabak kartoni Stilolapsa
Shënim	Për dokumente shtesë në mbështetje të temës mbi korrupsionin sugjerohet konsultimi i faqes së internetit: <u>https://www.transparency.org/cpi2018</u>



Korrupsioni nën Këndvështim

Fleta e mësuesit (vazhdimi)

Përmbledhje

Në fazën e parë, secili nxënës plotëson diagramën individualisht. Në shtyllën kurrizore të peshkut, nxënësit duhet të shkruajnë një përkufizim të korrupsionit. Në halat anësore duhet të listojnë shembujt, pasojat/efektet e korrupsionit në shoqëri, masat parandaluese / luftuese dhe vlerat themelore për të parandaluar / luftuar korrupsionin.

Në hapin e tjetër, në grupe me 4/5 persona, nxënësit duhet të krahasojnë diagramat e tyre, të diskutojnë mendimin e secilit dhe të plotësojnë një diagram të vetme të përbashkët në një fletë ose karton. Secili grup i paraqet klasës përfundimet e tij.

Në fund të këtij sesi çdo nxënës merr në shtëpi fletën me diagramën në mënyrë që t'i kërkojë një të rrituri (pjesëtar të familjes) që ta plotësojë atë.

Në fazën e dytë, nxënësit bashkohen në të njëjtin grup pune si më parë, dhe fillimisht krahasojnë diagramat e të rriturve me atë të tyre. Më pas, çdo grup duhet të përgatisë një poster informativ mbi Korrupsionin për t'ia paraqitur klasës dhe komunitetit shkollor. Grupet mund të plotësojnë të dhënat e grumbulluara edhe me informacione të marra nga burime të tjera (revista, libra, interneti), nëse kanë dëshirë.

Diskutimi

Ishte e lehtë apo e vështirë për të arritur një konsensus me anëtarët e tjerë të grupit gjatë zhvillimit të këtij aktiviteti? Pse?

A është perceptimi juaj për korrupsionin i njëjtë me të tjerët? Çfarë kanë të përbashkët dhe çfarë kanë të ndryshme?


Ndryshoi perceptimi juaj për korrupsionin pas reflektimit mbi perceptimin që kishin të tjerët për të?

Keni qënë ndonjëherë të përfshirë në ndonjë akt "korrupsionit"? Çfarë ndodhi? Çfarë ndjesie kishit? Nëse ajo situatë do të ndodhte sot, do të bënit të njëjtën gjë?

Keni qënë ndonjëherë një viktimë e "korrupsionit"? Çfarë ndjetë? Çfarë bëtë?

Cila është rëndësia e vlerave në parandalimin ose luftimin e korrupsionit?

Cilat janë përfundimet kryesore që mund të nxiren?



Korrupsioni nën Këndvështirm

Aktiviteti 1
Fleta e nxënësit

